

UNIVERSITETI AAB  
FAKULTETI EKONOMIK  
VITI AKADEMIK 2014/15 SEMESTRI DIMËROR  
PROGRAMI MASTER

**LËNDA: LIDERSHIPI DHE DALLIMET MENAXHUESE**

Ligjërues : Doc.Dr. Memet Memeti

Email: [memetseeu@yahoo.com](mailto:memetseeu@yahoo.com), [m.memeti@seeu.edu.mk](mailto:m.memeti@seeu.edu.mk)

Orari i konsultimeve: e Premte 16.30-17.30

“Çelësi i lidershipit të suksesshëm nuk është autoriteti, por ndikimi,, -Kenneth H. Blanchard

**QËLLIMI DHE MATERJA E STUDIMIT**

Zakonisht ndryshimet në nivel të organizatave/komunitetit i atribuohen lidershipit në organizatë/komunitet. Kjo lëndë është dizajnuar tu ofroj studentëve njohuri të thelluara mbi lidershipin si fenomen dhe ndikimin e tij në sjelljen organizative dhe individëve. Në këtë lëndë do të analizohen teoritë kyçe mbi lidershipin si dhe faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në procesin e lidershipit. Studentët do të analizojnë në mënyrë kritike fenomenin e lidershipit dhe kufizimet e teorive të ndryshme të lidershipit. Konceptet bazike në këtë lëndë do të përfshijnë temat si: lidershipi, sfidat e lidershipit, sfidat e liderit, ndikimi i lidershipit dhe ndikimi i liderëve në ndërtimin e organizatave/komuniteteve dhe raporteve në organizatë/komunitet. Vëmendje të posaçme do t'i kushtohet dijeve, qasjes dhe aplikimit të lidershipit.

**FORMATI I LËNDËS**

Kjo lëndë ka të bëjë me lidershipin dhe prandaj ka si qëllim tu ofroj kuptim të thelluar të dijeve të lidershipit duke ofruar konceptet teorike, informata praktike dhe mundësi për vetëvlerësim që do ju mundësoj studentëve të fillojnë dhe të zhvillojnë talentin e tyre në sferën e lidershipit. Studentët me anë të kësaj lënde do të përfitojnë dije dhe shkathtësi në kontekst të :

- Zhvillimit të kuptimit për anët e dobëta dhe anët e fuqishme në sferën e lidershipit
- Vlerësim të posedimit të karakteristikave dhe tipareve të duhura për një lider
- Zhvillimin e kapaciteteve për çdo format dhe stil të lidershipit

**REZULTATET E PRITURA**

Me përfundimin e lëndës studentët do të mund të:

- Të përshkruajnë dhe analizojnë lidershipin dhe rolin e veçantë të drejtuesve në organizatë/komunitet
- Identifikojnë dhe parashikojnë sfidat e lidershipit;
- Të kuptojnë dhe të marrin në konsideratë kompleksitetin e shkathtësive të lidershipit;

- Të kuptojnë se si liderët ndërtojnë organizata/komunitete të suksesshme duke u përqendruar në qartësinë organizative dhe në krijimin e kohezionit ekipor;
- Të dinë dhe aplikojnë pesë praktikatat e lidershit;
- Demonstrjnë se si fuqizohen raportet kyçe në mes stafit, udhëheqësit dhe komunitetit;

## METODAT E MËSIMIT DHE STUDIMIT

Mësimi do të zhvillohet në ligjërata interaktive. Në ligjërata studentët do njoftohen me konceptet dhe temat e parashikuara në sylabuin e lëndës.

## L I T E R A T U R A :

### Obligative :

- Leadership Theory and Practice, Six Edition  
Peter G. Northouse, Sage Publications.; 2012
- Antonakis, J., & Cianciolo, A. T. & Sternberg, R. J.(Eds.). (2004). The nature of leadership.  
Thousand Oaks: Sage Publications

### Literaturë shtesë:

- The Leadership Challenge, James M. Kouzes and Barry Z. Posner, Jossey-Bass 2002
- The One Thing You Need to Know, About Great Managing, Great Leading and Sustained Individual Success, Marcus Buckingham, Free Press 2005
- Bad Leadership, What It Is, How It Happens, Why It Matters  
Barbara Kellerman, Harvard Business School Press 2004

## LEKSIONET

Për çdo temë do të keni leksione në word apo power point. Pyetjet në vlerësimet me shkrim do të jenë nga këto leksione. Çdo material në formë të leksioneve, udhëzimeve apo informatave mund të merret nëpërmjet postës elektronike: [memetseeu@yahoo.com](mailto:memetseeu@yahoo.com)

## KRITERIUMI I NOTIMIT

Nota përcaktohet dhe bazohet në vlerësimin e arritjeve të studentit gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve (pjesëmarrja në diskutimet, prezantimet), në kolokuimin dhe provimin përfundimtar.

Universiteti përdor numra për vlerësimin e studentëve. Notat 6-10 janë nota kaluese, ndërsa nëse student/i vlerësohet me notën 5 nuk do të kalojë lëndën.

Nota e papërfunduar mund të jepet nëse student/i nuk ka kryer të gjitha kërkesat e lëndës deri në fund të semestrit, por ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të punës. Është përgjegjësia e studentit t'i

plotësojë në mënyrë të kënaqshme kërkesat e parashtruara në syllabusin e lëndës. Nëse kërkesat e parashtruara nuk përmbushen brenda një viti, automatikisht shënohet nota jo-kaluese.

Pikët	Nota		Përshkrimi i notës
91 – 100	10	A/A+	Outstanding
81 – 90	9	A-/B+	Excellent
71 – 80	8	B-	Very good
61- 70	7	C	Good
51 – 60	6	D	Satisfactory
0 – 50	5	F	Failing
Incomplete	IN	N/A	
No Record	NR	N/A	

### **Komponentët e notimit**

Ne kete lende jane parapare dy modele te notimit: Modeli A dhe Modeli B. Studenti mund te zgjedh njerin nga dy modelet e notimit. Data e kollokviumit eshte dita kur student percaktohet per modelin gjegjes. Pas perzgjedhjes se njerit model student nuk mund te nderoj modelin e vleresimit.

#### **Modeli A**

Nota e studentit sipas modelit A do të përcaktohet duke marrë parasysh komponentët që vijojnë:

Komponentët	Pikët maks.
Prezenca dhe aktiviteti	10
Analizë e Lidershipit	25
Plani akcional i lidershipit	10
Kollokviumi	20
Provimi përfundimtar	35

#### **Modeli B**

Nota e studentit sipas modelit B do të përcaktohet duke marrë parasysh komponentët që vijojnë:

Komponentët	Pikët maks.
Prezenca dhe aktiviteti	10
Kollokviumi	45
Provimi përfundimtar	45

**Me rëndësi:** nota përfundimtare bazohet në punën e përgjithshme gjatë gjithë semestrit dhe nuk përcaktohet vetëm nga arritja në provimin përfundimtar. Për tu vlerësuar studentit duhet të përmbush të gjitha kërkesat e parapara në sylabus.

## **PJESËMARRJA NË LIGJËRATA DHE USHTRIME**

Pjesëmarrja në ligjërata është parakusht për kryerjen e suksesshme të kërkesave të lëndës. Gjatë ligjëratave kërkohet aktivitet nga ana e studentëve. Gjatë semestrit studentët do të nënshtrohen kuizeve të paparalajmëruara ku do të mbulohen konceptet e përgjithshme të diskutuara në ligjëratën paraprake.

## KOMPONENTËT E NOTËS

### 1.PUNIM– ANALIZË E LIDERSHIPIT (4 STUDENTË maksimum 10 faqe)

Të identifikohet një organizatë/ komunitet dhe të analizohen praktikat e lidershipit në këtë organizatë/komunitet

Në këtë punim studentët do të identifikojnë:

- **1. Identifikoni një person që është lider në një kontekst (organizate, komuniteti) :**

Intervista duhet të mbulojë sferat që vijnë:

- Të dhëna bazike biografike dhe të bazike për organizatën/komunitetin
- Të dhëna mbi problemin/çështjen të cilin lideri mundohet të adresoj, cilat ndryshime janë arritur në bazë të mendimit të tij?
- Problemet me të cilat ballafaqohet lideri ?
- Me cilët individ apo organizata lideri ka bashkëpunuar për t'i arritur ndryshimet e parapara?
- Si e definojnë lidershipin, çka është me rëndësi sipas tij për një lidership efektiv?

- **2. Identifikoni një apo më tepër pasues/ndjekës (intervistë, fokus grupe, anketa) që janë të ndikuar nga lideri në pikën 1.**

Dizajnoni pyetje me të cilat do të merrni perceptimet e tyre mbi lidershipin e liderit në kontekstin e organizatës/ komunitetit të tyre?

- Arritjet e organizatës/komunitetit, sipas tyre?
- Problemet, sfidat e organizatës/komunitetit sipas tyre?
- Si e perceptojnë lidershipin e liderit në fjalë?
- Çka është me rëndësi sipas tyre për një lidership efektiv?

Nga analiza në terren dhe konceptet teorike të diskutuara në ligjërata, definojnë cilin model të lidershipit e implementon lideri, a ka dallime në mes liderit dhe pasuesve në perceptimin se çka është me rëndësi për një lidership efektiv, dallim në lidhje me suksesin dhe dallim në lidhje me problemet në organizatë. Ofron analizë kritike të lidershipit duke identifikuar probleme eventuale dhe ofruar modele alternative për një lidership më efektiv në kontekstin e dhënë

Punimi duhet të jetë maksimum dhjetë faqe, Times New Roman font 12, duke përfshirë komponentët që vijojnë:

- Hyrje (Konceptet teorike, skenim të organizatës/ komunitetit)
- Metodologjia–qëllimi, shtrirja, dhe instrumentet metodologjike
- Perspektiva/këndvështrimi e liderit
- Perspektiva/këndvështrimi i pasuesve/ndjekësve/vartësve
- Dallimet në mes perspektivës së liderit dhe pasuesve/ndjekësve/vartësve
- Analiza kritike–modele/qasje alternative
- Konkluzion

## 2. PLANI AKCIONAL I LIDERSHIPIT (PUNË INDIVIDUALE)

Në këtë komponentë studentët janë të obliguar të reflektojnë për veten e tyre dhe lidërshtipin. Tradita familjare dhe ndikimi i saj në perceptimin mbi lidërshtipin, vetëdijesimi për potencialin për lider ? Cilët përvoja kanë ndikuar në vlerat dhe filozofinë tuaj për lidërshtipin? Si e keni perceptuar lidërshtipin ne fillim te semestrit dhe si e perceptoni ne fund te semestrit. Gjithashtu, plani akcional ka të bëj me reflektim të anëve të fuqishme dhe të dobëta dhe si do të adresohen këto anë të fuqishme dhe anë të dobëta në të ardhmen. Përqendrohuni në filozofinë tuaj mbi lidërshtipin dhe reflektoni nëse kjo filozofi ka ndryshuar gjatë këtij semestri, nëse po, përshkruaj si ka ndryshuar. Cilët janë hapat që do t'i ndërmerni të zhvilloni kapacitetet e lidërshtipit në të ardhmen.Pra çka do të ndërmerni në afat të shkurtër në afat të mesëm dhe në afat të gjatë të përmirësoni anët e dobëta të lidërshtipit. Maksimum 3 faqe

## 3. KOLLOKVIUMI DHE PROVIMI PËRFUNDIMTAR

Kollokviumi dhe provimi përfundimtar do të jenë me shkrim, në formë të pyetjeve të mbyllura, definicioneve dhe eseve, më hollësisht për formën e provimit përfundimtar do të informoheni gjatë sesioneve përgatitore.

## NDERSHMËRIA AKADEMIKE

Çdo student duhet tu përmbahet rregulloreve për ndershmëri akademike. Studenti që do të kopjoj (në provim, kolokuium, në përmbushjen e kërkesave tjera të lëndës), apo në ndonjë formë tjetër do të përfshihet në shkelje të rregullave për ndershmëri akademike do të vlerësohet me notë jo kaluese, dhe për këtë do të lajmërohen instancat më të larta të fakultetit.

JAVA I	Njoftim i përgjithshëm për lëndën, rëndësinë dhe qëllimet e studimit, sylabusi, vlerësimi dhe notimi Udhëzime për komponentët e notës.  Ligjëratë: Koncepti i lidërshtipit
--------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përkufizimi</li> <li>• Lidershipi si qasje e tipareve personale përkundrejt lidershipit si proces</li> <li>• Lidershipi formal dhe joformal</li> <li>• Lidershipi dhe pushteti</li> <li>• Lidershipi dhe menaxhmenti</li> </ul>
JAVA II	<p>Ligjëratë: Lidershipi si tërësi e tipareve (Trait Approach)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studimet mbi trajtat dhe karakteristikat e liderit</li> <li>• Modeli i pesë faktorëve të personalitetit dhe lidershipit</li> <li>• Intelejjenca emocionale</li> </ul>
JAVA III	<p>Ligjëratë: Lidershipi si shkathtësi (Skills Approach)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkathtësitë teknike</li> <li>• Shkathtësitë human</li> <li>• Shkathtësitë konceptuale</li> <li>• Kompetenca dhe lidershipi</li> </ul>
JAVA IV	<p>Ligjëratë: Stilet e lidershipit (Style Approach)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrjeti menaxherial sipas Blake dhe Mouton</li> <li>• Paternalizmi/Maternalizmi</li> <li>• Oportunizmi</li> </ul>
JAVA V	<p>Ligjëratë: Lidershipi i bazuar në situatë (Situational Approach)</p>
JAVA VI	<p>Kollkvium</p>
JAVA VII	<p>Ligjëratë: Teoria proces-qëllim (Path-Goal Theory)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sjellja e liderit</li> <li>• Karakteristikat e vartësve</li> <li>• Karakteristikat e detyrave</li> </ul>
JAVA VIII	<p>Ligjëratë: Teoria e interaksionit lider-anëtar (Leader-member Exchange)</p>
JAVA IX	<p>Ligjëratë: Lidershipi adaptues (Transformational Leadership)</p>

JAVA X	Ligjëratë: Lidershipi ekipor (Team Leadership)
JAVA XI	Ligjëratë: Qasja Psikodinamike (Psychodynamic Approach)
JAVA XII	Ligjëratë: Gratë dhe Lidershipi
JAVA XIII	Ligjëratë: Konteksti kulturor dhe Lidershipi
JAVA XIV	Ligjëratë: Etika dhe Lidershipi
JAVA XV	Rikapitulim i materialit